



Republika e Kosovës
Komuna e Mitrovicës Jugore

Bazuar në nenin 9 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën Kosovës, nenin 17, pika (f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15, paragrafi 1 nënparagrafi 1.8, të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, sipas Ligjit 03/L-041 për kufinjët Administrativ Komunal, neni 18, paragrafi 1, pika 1.5 dhe 1.6 të Statutit të Komunës, me datën 09.01.2026 arrihet kjo:

MARRËVESHJE PËR SHËRBIME NË FSHIRJE DHE LARJE TË RRUGËVE DHE LARGIMIN E DEPONIVE ILEGALE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË MITROVICËS

Palët e marrëveshjes:

Komuna e Mitrovicës së Jugut, të cilën e përfaqëson z. Faton Peci, Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejshme komuna).

KRM "Uniteti" Sh.A, në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson z. Ylber Murtezaj, U.D. Kryeshf Ekzekutiv (në tekstin e mëtejshme "Uniteti").

Neni 1

Përkufizimet

- 1.1 Shkurtesat në kuptim të kësaj marrëveshjeje kanë këtë domethënie:
- 1.2. KRM - Kompania Regjionale e Mbeturinave
- 1.3. MSH -Marrëveshja për shërbime
- 1.4. DSHPI – Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë

Neni 2

Qëllimi

- 2.1.Qëllimi i marrëveshjes:
- 2.2. Përcaktimi i shërbimeve që KRM "Uniteti" - në Mitrovicë, i ofron komunës dhe standardet e kërkuara për mënyrën e ofrimit, operimit dhe menaxhimit të këtyre shërbimeve.
- 2.3. KRM "Uniteti" dhe Komuna e Mitrovicës së Jugut t'i kryejnë obligimet të specifikuar sipas kësaj marrëveshjeje.
- 2.4. Përshkrimi i kërkesave për menaxhimin cilësor të shërbimeve, duke përfshirë specifikacionet e shërbimit, monitorimin e performancës dhe raportimin.

Neni 3

Fushëveprimi i shërbimit, kohëzgjatja dhe kushtet themelore

3.1 Komuna e Mitrovicës së Jugut dhe "Uniteti" në Mitrovicë, dakordohen për t'i kryer të gjitha shërbimet në përputhje me këtë marrëveshje.

3.2. Kjo marrëveshje vlen për periudhën, nga data 09 Janar 2026 deri më 31 Prill 2026.

3.3. Gjatë kohëzgjatjes të kësaj marrëveshje, "Uniteti" do të bëjë fshirjen dhe larjen e rrugëve të qytetit të Mitrovicës së Jugut sipas planit të punës, përkatësisht dinamikës e cila do ti dorëzohet nga personi përgjegjës/menaxheri i kësaj marrëveshjeje.

3.4. Gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje, "Uniteti" do të fshijë dhe lajë rrugët e qytetit të komunës së Mitrovicës Jugore, zonës së kufijve komunal siç është përkufizuar në shtojcën A.

3.5. KRM "Uniteti" e siguron tërë personelin dhe pajisjet e nevojshme (siç janë përkufizuar këtu) për të ofruar një shërbim të kënaqshëm, në mënyrë që të jetë në përputhje me specifikacionet e shërbimit që janë përfshirë në shtojcën A të kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Shërbimet që do të ofrohen

4.1. Shërbimet që do të ofrohen sipas kësaj marrëveshje (sipas standardeve të detajuara të shërbimit që janë paraparë në shtojcën A, fshirjen dhe larjen e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike, zbrazja e shportave rrugore, larja e shtigjeve të këmbësorëve dhe shesheve me preparate dhe deponitë ilegale.

Neni 5

Objektivat kryesore të këtyre shërbimeve

5.1. Të ofrojnë shërbime në mënyrë cilësore dhe efikase në përputhshmëri me standardet mjedisore.

5.2. Të mbrohen banorët dhe mjedisi nga ndotja dhe rreziqet e tjera ndaj shëndetit.

Neni 6

Fuqia madhore

6.1. Nga "Uniteti" nuk do të kërkohet që t'i kryejë shërbimet që janë saktësuar në neni 4 si më lart nëse pengohet për ta bërë këtë nga ndonjë fuqi madhore.

6.2. Me termin "Fuqi madhore" brenda kësaj kontrate nënkuptojmë një ngjarje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një pale, e cila shkakton pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve të palës në këtë marrëveshje ose është jopraktike dhe konsiderohet e pamundur për shkak të rrethanave të krijuara. Ajo përfshin, luftën, protestat, mosbindjen civile, tërmetin, zjarrin, shpërthimet, stuhitë, përmblytjet, etj.

6.3. Fuqia madhore nuk përfshin një ngjarje e cila shkaktohet nga neglizhenca apo veprimi me qëllim i njëtrës palë apo agjentëve ose punëmarrësve të saj; asnjë ngjarje të cilën një palë e kujdosshme në mënyrë të arsyeshme duhet ta kishte marrë parasysh në kohën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe që mund të ishte shmangur ose tejkaluar me përmbushjen e detyrimeve në këtë marrëveshjeje.

6.4. Fuqia madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve për të operuar ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni 7

Standardet specifike të shërbimit

7.1. Shërbimet e fshirjes dhe larjes së rrugëve ofrohen në përputhje me specifikacionet e hollësishme të shërbimit që janë paraparë në shtojcën A dhe që janë përmbledhur.

Neni 8

Mbledhja, transportimi dhe deponimi i mbeturinave nga shportat rrugore të vendosura në qytet

8.1. KRM "Uniteti" siguron që të ofroj shërbim një herë në ditë për zbrazjen e shportave rrugore të vendosura në qytet.

8.2. KRM "Uniteti" ofron shërbim të rregullt dhe të besueshëm të mbledhjes së mbeturinave nga shportat rrugore të vendosura në qytet, duke u siguruar që të gjitha mbeturinat nga shportat rrugore që (apo që janë derdhur përreth tyre) të mbledhen dhe transportohen në vendet e caktuara.

8.3. Ky shërbim do të ofrohet duke u bazuar në Sistemin e itinerarit përkatësisht në lokacionet e shportave rrugore, të cilat janë të vendosura nga Drejtoria gjegjëse e Komunës së Mitrovicës.

8.4. Për shtimin e shportave rrugore përgjegjëse është vet Komuna e Mitrovicës së Jugut e cila ka për obligim që me kohë të njoftoj "Uniteti" për lokacionin dhe numrin e shportave rrugore në mënyrë që të përfshihen në sistemin e itinerarit të mbledhjes.

8.5. Sipas kërkesës së bërë paraprakisht nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës shërbime shtesë mund të kërkojnë sipas nevojës, edhe në ditët para ose pas festave zyrtare.

Neni 9

Mbulimi me shërbime

9.1. KRM "Uniteti" sipas kësaj marrëveshje është përgjegjëse që të ofrojë shërbime në fshirje dhe larje të rrugëve, zbrazjen e shportave rrugore të vendosura në qytet, largimin e mbeturinave dhe materialeve të forta – deponi ilegale si dhe larjen e shtigjeve të këmbësorëve dhe shesheve me preparate, siç është përkufizuar në këtë marrëveshje. "Uniteti" është përgjegjës për pastërti në hapësirën e definuar.

Neni 10

Resurset dhe shkathtësitë

10.1. Shërbimet e ofruara nga "Uniteti" do të ofrohen nga një ekip i trajnuar në mënyrë adekuate dhe profesionale që i posedon shkathtësitë relevante për ta kryer shërbimin.

10.2. Në të gjitha objektet dhe vendet e caktuara për këtë shërbim punësohen anëtarë të trajnuar të personelit, të specializuar në detyrat përkatëse të tyre.

10.3. Ekipi i menaxhimit "Uniteti" ndërlidhet dhe bashkërendohet me komunën dhe është i hapur për inspektim nga përfaqësuesit e komunës (Organi Mbikëqyrës Komunal) në çdo kohë.

10.4. "Uniteti" siguron numër adekuat të punonjësve me shkathtësinë dhe trajnimin e duhur për t'i kryer shërbimet sipas kësaj marrëveshje. Secili punonjës mban veshur rroba që janë sa më të rregullta dhe më të pastra që i lejojnë rrethanat dhe mban rroba mbrojtëse personale, siç janë jelekët me dukshmëri të lartë, dorëzat e qëndrueshme edhe çizmet e helmetat e sigurisë sipas nevojës.

10.5. Para datës së fillimit të implementimit të kësaj marrëveshje, "Uniteti" ua ofron përfaqësuesve të komunës një listë të detajuar në të cilën përshkruhen pajisjet (përkatësisht automjetet dhe kamionët për këtë shërbim) dhe burimet njerëzore që do të përdoren për t'i kryer shërbimet.

Neni 11

Monitorimi dhe raportimi

11.1. KRM "Uniteti" duhet të mbajë "Ditar Ndërtimor" dhe të evidentoj në baza ditore për punët e kryera sipas kësaj marrëveshjeje, po ashtu do të dorëzon raportin e punëve të kryera.

11.2. Elementet e detyrueshme që duhet të raportohen përfshijnë sipërfaqet e m² të rrugëve të fshira, sipërfaqet e m² të rrugëve të lara, sipërfaqet e m² të shtigjeve të këmbësorëve dhe shesheve me preparate (vetëm me urdhërin e autoritetit kontraktues), sasi të mbeturinave të mbledhura (në ton) nga deponitë ilegale dhe numrin e shportave rrugore të zbrazura.

11.3. Këto raporte verifikohen dhe monitorohen nga organi mbikëqyrës komunal, ose përmes zyrtarit/menaxherit të kësaj marrëveshjeje, si dhe në terren përmes vizitave.

Neni 12

Përgjegjësitë e komunës

12.1. Komuna do të mbikëqyrë rregullisht, përmes një komisioni/organi mbikëqyrës komunal për menaxhim të marrëveshjes dhe të përpilojë raporte për mbikëqyrjen, gjendjen e konstatuar, masat dhe veprimet që janë marrë, përkatësisht urdhëruar.

12.2. Një kopje e raportit pasi që është verifikuar dhe pranuar nga organi mbikëqyrës komunal duhet t'i dorëzohet "Unitetit".

12.3. Komuna mund ta testojë rregullisht kënaqësinë e konsumatorëve me shërbimet e ofruara, duke përcaktuar procedura adekuate dhe duke e nxjerrë një raport të shkurtër për nivelin e kënaqjes së konsumatorëve.

12.4. Komuna është e obliguar që përveç vendosjes së shportave rrugore, të bëjë zëvendësimin e të njëjtave në rastet kur ato dëmtohen, janë të pa shfrytëzueshme për arsye të ndryshme.

Neni 13

Përgjegjësitë e KRM "Uniteti"

13.1. T'i kryejë shërbimet në përputhje me këtë marrëveshje me tërë shkathtësinë dhe kujdesin e duhur.

13.2. Të respektoj dhe zbatoj dinamikën e punëve për fshirjen dhe larjen e rrugëve e cila paraprkishtë do të përgatitet nga Organi Mbikëqyrës Komunal.

13.3. Të mbledhë, transportojë, trajtojë dhe deponojë të gjitha mbeturinat e larguara nga deponitë ilegale.

13.4. Të sigurohet që të gjitha mbeturinat e mbledhura nga deponitë ilegale të dërgohen në deponinë sanitare regjionale në "Gërmovë" apo ndonjë deponi tjetër të caktuar nga komuna.

13.5. Të marrë veprime për t'u siguruar që asnjë mbeturinë e grumbulluar të mos depozitohet ilegalisht apo pa vend, duke e ndotur mjedisin dhe duke e rrezikuar shëndetin e popullatës.

13.6. Në rast të paraqitjes së nevojës për punë shtesë përkatësisht jashtë dinamikës, atëherë Organi Mbikëqyrës Komunal, do të njoftoj me kohë dhe atë të paktën njëzetekatër (24) orë më herët tek menaxheri i kësaj marrëveshjeje të përcaktuar nga menaxhmenti i "Uniteti"-it. Kërkesa e paraqitur nga Organi Mbikëqyrës Komunal, do të bëhet me shkrim, përmes email adresës, përmes telefonit, shkresës zyrtare të përcjellë përmes postës.

13.7. Të jetë përgjegjës për zbatimin e orarit dhe të bëjë raportimin për progresin, parashikimin dhe kontrollimin e pavarur për ta arritur kryerjen e shpejtë dhe efikase të shërbimeve.

13.8. Të ketë dhe mirëmbajë një linjë telefonike pa pagesë dhe publikisht të dukshme brenda "Unitetit", me një numër të telefonit dhe/ose adresë të postës elektronike në të cilën mund kontaktohet në çdo kohë të ditës dhe të jetë në gjendje t'i pranojë ankesat dhe në sekretariatit e operativës/selisë së "Unitetit".

13.9. Ankesat do të evidentohen dhe përgjigjet në to do të jepen në mënyrë të shpejtë, të njerëzishme dhe efikase, si dhe duhet të mbahen dhe të vihen në dispozicion për inspektim evidenca me shkrim për të gjitha ankesat që janë pranuar dhe veprimet që janë marrë në lidhje me ankesat e tilla.

13.10. Të sigurojë mirëmbajtjen e rregullt dhe preventive të të gjitha automjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të saktësuar, në mënyrë që të ngritet në maksimum produktiviteti dhe jetëgjatësia e pajisjeve për përdorim.

13.11. Të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha pajisjeve që përdoren në lidhje me ofrimin shërbimeve të përshkruara në këtë marrëveshje.

13.12. Është përgjegjës për të siguruar kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.

Neni 14

Faturimi dhe pagesa

14.1. Faturimi do të bëhet në baza mujore dhe fatura dorëzohet nga "Uniteti" tek Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë (DSHPI).

14.2. Komuna e Mitrovicës së Jugut, përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë (DSHPI) paguan "Unitetin" për shërbimin e kryer, në bazë të faturës së pranuar.

14.3. Pagesën për shërbim do ta paguajë Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë (DSHPI) për "Unitetin" dhe do të bëhet në bazë të raportit të dorëzuar.

14.4. Çmimi për shërbimet e ofruara nga "Uniteti" janë të përcaktuar në tabelën në shtojcën A të kësaj marrëveshjeje.

14.5. "Uniteti" do t'i dorëzojë Komunës së Mitrovicës së Jugut përkatësisht Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë (DSHPI) faturën për shërbimin e kryer më së largu deri më datë 5 të muajit pasues. Nëse data 5 korrespondon me ditë pushimi, atëherë fatura do të dorëzohet në ditën e parë pasuese të punës.

14.6. Komuna e Mitrovicës së Jugut, përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë (DSHPI), do të bëjë pagesën e shërbimit për "Unitetin", deri më datë 15 të muajit pasues. Nëse data 15 korrespondon me ditë pushimi, atëherë pagesa bëhet në ditën e parë pasuese të punës.

Neni 15
Obligimet e Komunës

15.1. Komuna obligohet para se ti transferoj mjetet financiare tek KRM "UNITETI", të njoftojë atë, në mënyrë që kjo e fundit të kërkojë që këto mjete të shfrytëzohen për shërbime më të mira për konsumatorët e territorit të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Neni 16
Obligimet e KRM "UNITETI"

16.1. Mjeteve financiare të pranuar nga Komuna e Mitrovicës - Jug për KRM "UNITETI", t'i jepet prioritet që të përdorën për interesat dhe nevoja e KRM "UNITETI" Njësia në Mitrovicë, për shërbime më të mira për konsumatorët e territorit të Komunës së Mitrovicës Jugore.

Neni 17
Ndërprerja e parakohshme e marrëveshjes

17.1. Kjo marrëveshje mund të ndërpritet para afatit për të cilin është lidhur me pajtimin e të dyja palëve me shkrim ose nëse cilado palë jep njoftim me shkrim për ndërprerje të marrëveshjes, para skadimit.

17.2. Nëse "Uniteti" nuk i ofron shërbimet e dakorduara në përputhje me standardet e shërbimit që janë përcaktuar në këtë marrëveshje gjatë një periudhe të vazhdueshme prej një muajsh, kjo marrëveshje do të ndërpritet automatikisht dhe komuna nuk do të jetë e obliguar ta paguajë asnjë faturë të dorëzuar për shërbimet e ofruara gjatë kësaj periudhe.

Neni 18
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

18.1. Kontestet që ndërlidhen me shërbimin e ofruar dhe të paguar në kuadër të kësaj marrëveshje zgjidhen në radhë të parë, gjatë takimeve kontaktuese operative të rregullta. Çdo çështje që ka të bëjë me shërbimet e ofruara apo standardet e përshkruara në këtë marrëveshje dhe që mbetet e pazgjidhur pasi të jetë trajtuar fillimisht duhet të shkallëzohet si vijon:

18.2. Nëse nuk mund të arrihet një zgjidhje midis "Unitetit" dhe komunës, duhet të merret në konsideratë arbitrazhi i jashtëm (Gjykata Themelore në Mitrovicë), ndërsa për çdo shpenzim përkatës do të vendosë gjykata.

3. Derisa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia, "Uniteti" do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj marrëveshje.

Neni 20
Ndëshkimet në rast të mos përmbushjes së marrëveshjes

20.1. Në rast se shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në këtë marrëveshje, atëherë Organi Mbikëqyrës Komunal do të kërkojë që puna të përmirësohet në ditën në vijim.

20.2. Derisa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia, "Uniteti" do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj marrëveshje.

Neni 21

Rishikimi i marrëveshjes

21.1. Kjo marrëveshje dhe të gjitha pjesët përbërëse të saj do të rishikohen sipas nevojës dhe me kërkesë të Komunës së Mitrovicës - Jug.

21.2. Rishikimi do të përqendrohet në cilësinë e shërbimit të ofruar, duke përfshirë zgjerimin e dinamikës së punëve të përcaktuar nga Organi Mbikëqyrës Komunal.

21.3. Për çdo ndryshim/ndërrim në shërbimet e ofruara që do të ndikojë gjatë implementimit të kësaj marrëveshje duhet të dakordohet nga të dyja palët.

Neni 22

Nënshkrimi i marrëveshjes

22.1. Kjo marrëveshje nënshkruhet në katër (4) ekzemplarë, nga dy (2) ekzemplarë për secilën palë në këtë marrëveshje.

22.2. Pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje është shtojcat A.

Neni 23

Hyrja në fuqi

23.1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve të kësaj marrëveshje.

Palët e marrëveshjes

z.Faton Peci

Kryetar i Komunës së Mitrovicës Jugore



z.Ylber Murtezaj

U.D. Kryeshef Ekzekutiv i KRM
"Uniteti" Mitrovicë



Shtojca A – Standardet e detajuara të shërbimit

Shërbimi i fshirjes dhe larjes së rrugëve në qytetin e Komunës së Mitrovicës – Jug, konsiston në:

- a) Fshirjen dhe larjen e rrugëve sipas dinamiklës së përcaktuar paraprakisht nga Organi Mbikëqyrës Komunal, duke përdorur makineri adekuate për këtë shërbim si: Cisterna dhe autofshisa.
- b) Zbrazja e shportave rrugore në baza të rregullta ditore (një herë në ditë) si dhe hapësirat rreth shportave
- c) Largimi i deponive ilegale do të bëhet në afat sa më të shkurtër kohor dhe sipas urdhëresës së organit kompetent komunal.
- d) Larja e shtigjeve të këmbësorëve dhe shesheve me preparate, do të bëhet sipas urdhëresës së organit kompetent komunal.

Fshirja dhe larja e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike duke përfshirë edhe larjen e shtigjeve të këmbësorëve dhe shesheve me preparate, largimin e mbeturinave dhe materialeve të forta – deponitë ilegale si dhe zbrazjen e shportave rrugore të vendosura nëpër qytet.

I. Larja e rrugëve me makina adekuate me presion të shtuar te ujit

Jr.	Rmërtimi I rrugëve dhe shesheve	Siperfaqja m2 (për rrugë)	Sasia	Çmimi/nj ësi pa TVSH	TVSH	Çmimi/ njësi meTVS H	TOTALI
1	Bulevardi "Mbretëresha Teuta " & Isa Boletini	22140	1	0.0167	0.0013	0.018	398.52
2	Artim Jashari & Safet Boletini	6517	1	0.0167	0.0013	0.018	117.30
3	Driton M. Veliu	8000	1	0.0167	0.0013	0.018	144.00
4	Ukshin Kovaqica	9442.5	1	0.0167	0.0013	0.018	169.97
5	Ahmet Selaci ,Martiret e Kombit, Xhafer Deva dhe Pajazit Boletini	6650	1	0.0167	0.0013	0.018	119.70
6	Hasan Prishtina	1050	1	0.0167	0.0013	0.018	18.90
7	Sheshi Skënderbeu	1130	1	0.0167	0.0013	0.018	20.34
8	Sheshi i Lirisë	3500	1	0.0167	0.0013	0.018	63.00
9	Bulevardi "Shemsi Ahmeti " & " Brigada 141 Mehe Uka "	22500	1	0.0167	0.0013	0.018	405.00
10	Sheshi Isa boletini	5012.92	1	0.0167	0.0013	0.018	90.23
11	Sheshi Agim Hajrizi	2536.72	1	0.0167	0.0013	0.018	45.66
12	Sheshi Mehe Uka	3284.33	1	0.0167	0.0013	0.018	59.11
13	Sheshi Afrim Zhitia	1642.72	1	0.0167	0.0013	0.018	29.56
14	Sheshi Adem Jashari	6580.18	1	0.0167	0.0013	0.018	118.44
15	Bedri Gjina & Adem Voca	4597	1	0.0167	0.0013	0.018	82.74
16	Fatime Hetemi	700	1	0.0167	0.0013	0.018	12.60
17	UÇK-Ibrahim Popovci	8000	1	0.0167	0.0013	0.018	144.00
18	Selman Vojvoda & Deshmoret e Kombit	22800	1	0.0167	0.0013	0.018	410.40
19	Agim Ramadani Katana & Fan Noli te dielli	4368	1	0.0167	0.0013	0.018	78.62
20	Muhamet Gashi	3500	1	0.0167	0.0013	0.018	63.00
21	Evlija Çelebia	2025	1	0.0167	0.0013	0.018	36.45
22	Bislim Bajgora	5082.5	1	0.0167	0.0013	0.018	91.48
23	Ramadan Kelmendi	6780	1	0.0167	0.0013	0.018	122.04
24	Avni Shabani	652.5	1	0.0167	0.0013	0.018	11.74
25	Miran Hajra	1045	1	0.0167	0.0013	0.018	18.81
26	Kemajl Ataturku	1294.25	1	0.0167	0.0013	0.018	23.30
27	Deriton Veliu -Suhodoll	2365	1	0.0167	0.0013	0.018	42.57
28	Rruga Liqeni	11250	1	0.0167	0.0013	0.018	202.50
29	Shetitorja te Liqeni	9000	1	0.0167	0.0013	0.018	162.00
30	Lah Nimani	1834.33	1	0.0167	0.0013	0.018	33.00

I. Fshirja e shtigjeve te kembesorve , trotuareve shesheve dhe skajeve te rrugëve me fshisa dore dhe makina adekuate.

Nr.	Emërtimi I rrugëve dhe shesheve	Siperfaqja m2 (për rrugë)	Sasia	Çmimi/nj ësi pa TVSH	TVSH	Çmimi/ njësi meTVS H	TOTALI
1	Bulevardi "Mbretëresha Teuta " & Isa Boletini	13284	1	0.0167	0.0013	0.018	239.11
2	Artim Jashari & Safet Boletini	2793	1	0.0167	0.0013	0.018	50.27
3	Driton M.Veliu	2000	1	0.0167	0.0013	0.018	36.00
4	Ukshin Kovaqica	6892.5	1	0.0167	0.0013	0.018	124.06
5	Ahmet Selaci ,Martiret e Kombit, Xhafer Deva dhe Pajazit Boletini	2850	1	0.0167	0.0013	0.018	51.30
6	Hasan Prishtina	490	1	0.0167	0.0013	0.018	8.82
7	Sheshi Skënderbeu	1130	1	0.0167	0.0013	0.018	20.34
8	Sheshi i Lirisë	3500	1	0.0167	0.0013	0.018	63.00
9	Bulevardi "Shemsi Ahmeti " & " Brigada 141 Mehe Uka "	10500	1	0.0167	0.0013	0.018	189.00
10	Sheshi Isa boletini	5012.92	1	0.0167	0.0013	0.018	90.23
11	Sheshi Agim Hajrizi	2536.72	1	0.0167	0.0013	0.018	45.66
12	Sheshi Mehe Uka	3284.33	1	0.0167	0.0013	0.018	59.11
13	Sheshi Afrim Zhitia	1642.72	1	0.0167	0.0013	0.018	29.56
14	Sheshi Adem Jashari	6580.18	1	0.0167	0.0013	0.018	118.44
15	Bedri Gjina & Adem Voca	1497.36	1	0.0167	0.0013	0.018	26.95
16	Fatime Hetemi	300	1	0.0167	0.0013	0.018	5.40
17	UÇK-Ibrahim Popovci	2286	1	0.0167	0.0013	0.018	41.14
18	Selman Vojvoda & Deshmoret e Kombit	3250	1	0.0167	0.0013	0.018	58.50
19	Agim Ramadani Katana & Fan Noli te dielli	1344	1	0.0167	0.0013	0.018	24.19
20	Muhamet Gashi	500	1	0.0167	0.0013	0.018	9.00
21	Evlija Çelebia	450	1	0.0167	0.0013	0.018	8.10
22	Bislim Bajgora	1070	1	0.0167	0.0013	0.018	19.26
23	Ramadan Kelmendi	5050	1	0.0167	0.0013	0.018	90.90
24	Avni Shabani	217	1	0.0167	0.0013	0.018	3.90
25	Miran Hajra	570	1	0.0167	0.0013	0.018	10.26
26	Kemajl Ataturku	167	1	0.0167	0.0013	0.018	3.00
27	Deriton Veliu -Suhodoll	1935	1	0.0167	0.0013	0.018	34.83
28	Rruga Liqeni	6000	1	0.0167	0.0013	0.018	108.00
29	Shetitorja te Liqeni	9000	1	0.0167	0.0013	0.018	162.00
30	Lah Nimani	1228	1	0.0167	0.0013	0.018	22.10

Pershkrimi i punëve	Njesia	Sasia	Qmimi për njësi pa TVSH	TVSH €/njesi	Çmimi njesi me TVSH €/njesi	Gjithsej €
---------------------	--------	-------	-------------------------	--------------	-----------------------------	------------

I	Larja e rrugëve me makina adekuate me presion të shtuar të ujit	m ²	1.00	0.0167	0.0013	0.018	0.018
II	Fshirja e shtigjeve të kembesoreve, trotuareve shesheve dhe skajeve të rrugëve me fshisë dore dhe makina adekuate.	m ²	1.00	0.0167	0.0013	0.018	0.018
III	Larja e shtigjeve të kembesoreve dhe shesheve me preparate, me urdherin e autoritetit kontraktues	m ²	1.00	0.93	0.07	1.00	1.00
IV	Largimi i mbeturinave dhe materialeve të forta në brez të rrugëve, bankinë dhe kanale	t	1.00	18.4	1.6	20.00	20.00
V	Zbrazja e shportave rrugore	copë	1.00	0.46	0.04	0.50	0.50

REKAPITULIMI

	Larja e rrugëve me makina adekuate me presion të shtuar të ujit		3334.98
I	Fshirja e shtigjeve të kembesoreve, trotuareve shesheve dhe skajeve të rrugëve me fshisë dore dhe makina adekuate.		1752.43
II	Larja e shtigjeve të kembesoreve dhe shesheve me preparate		1.00
V	Largimi i mbeturinave dhe materialeve të forta -deponit e egra		20.00
/	Zbrazja e shportave rrugore në copë		0.50
TOTALI			5108.91